

VENDIM
Nr.33, datë 15.2.2010

PËR SKEMËN EKZISTUESE TË SUBVENCIONIMIT TË HEKURUDHAVE

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

Z. Dritan Prifti	- Kryetar
Znj. Mimoza Dhëmbi	- Anëtare
Z. Arben Ndoci	- Anëtar
Z. Gjergj Thomai	- Anëtar
Z. Zef Preçi	- Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.2.2010, shqyrtoi raportin “Për disa skema ekzistuese të ndihmës, që duhet të sigurojnë përputhjen e plotë me legjislacionin europian”, të përgatitur nga Drejtoria e Ndihmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

BAZA LIGJORE: Si bazë ligjore për skemën është vendimi i Këshillit të Ministrave nr.45, datë 16.1.2008 “Për miratimin e raportit “Për inventarin e skemave ekzistuese të ndihmës shtetërore në Shqipëri”” dhe vendimi i Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr.8, datë 2.2.2007 dhe nr.15, datë 15.3.2007 “Për skemën ekzistuese të subvencionimit të hekurudhave”.

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, pasi shqyrtoi raportin e përgatitur nga Drejtoria e Ndihmës Shtetërore,

VËREN SE:

1. Ndërmjet MPPTT-së dhe HSH-së është nënshkruar kontrata për detyrimin e ofrimit të shërbimit publik për transportin hekurudhor të udhëtarëve dhe mbështetjen financiare nga ana e shtetit.
2. Edhe pse në parim janë bërë llogaritjet për subvencionimin e drejtpërdrejtë për të mbuluar koston e plotë të shërbimeve të transportit publik, rezultati financiar ka qenë negativ.
3. Nga ana e MPPTT-së, ende nuk është paraqitur një plan i plotë për zhvillimin e këtij sektori dhe vendin që ai do të zërë midis rrugëve të tjera të transportit.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, mbështetur në nenin 23 të ligjit nr.9374, datë 21.2.2005 “Për ndihmën shtetërore”, si dhe në nenin 19 të rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.817, datë 28.12.2005,

VENDOSI:

1. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit të përgatisë një plan të ristrukturimit të sektorit hekurudhor, ku të ketë përcaktuar masat që do t'i kthejnë rentabilitetin këtij sektori dhe afatet përkatëse.
 2. Plani i ristrukturimit të dorëzohet në Drejtorinë e Ndihmës Shtetërore brenda datës 30 shtator 2010, për t'u vlerësuar dhe për të marrë miratimin nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Dritan Prifti